



**BASHKIA LIBRAZHD**  
**Drejtoria e Bujqesise dhe Ushqimit**

**RELACION**

**OBJEKTI : RIPARIME NE VEPRAT UJITASE TE BASHKISE**

**Riparime te vogla ne veprat ujitese.** Ne shume vepra ujitese ka probleme te vogla te cilat kane nevojë per nderhyrje pasi ne te kundert pengohet ujitja gjate sezionit. Kryerja e ketyre punumeve, te vogla, eshte e domosdoshme ne krahasim me nevojat qe ka e tere vepra ujitese. Ne kushtet e nevojave te shumta per nderhyrje ne rrjetin ujites dhe mundesise se pamjaftushme te fondeve eshte menduar dhe projektuar qe per vitin 2019 te kryhen punime pjesore ne 9 objekte ujore duke investuar 4 423 235 leke.

Duke kryer kete investim do te permirsohet ujitja ne 215 ha duke perfituar 370 fermere. Punime jane parashikuar te kryhen ne veprat ujore:

- a) **Riparim veper marrja e kanalit ujites Gjere – Mirake** . Permirson ujitjen ne 70 ha duke perfituar mbi 90 fermere. Arsyeya e kesaj nderhyrje eshte sepse vitin e kaluar si pasoje e filtrimeve te medha ne pjesen e marrjes, me gjatesi 180 ml , humbjet e ujit sollen veshtersi ne perballimin e nevojave per uje. Punimet konsistojne ne veshjen me beton dhe kalimin e nje perroi me ure kanal.
- b) **Riparim ne kanal in e Ballollit.** Ky kanal ndodhet ne fshatin Polis te njesise administrative Polis . Ne kete kanal ka nje segment me gjatesi 218 ml ne te cilin kalimi ujit eshte shume problem per arsye te terrenit. Me kete kanal ujitjen 8 ha duke perfituar mbi 20 familje.
- c) **Kanali Gurakuq –FLOQ.** Ne kete kanal eshte investuar por ka probleme te cila duhen zgjidhur patjeter sepse pengohet ujitja. Per kete qellim eshte planifikuar te kryhen punime ne veper marrje si ndertimi i nje prite dhe saldime tubacioni. Punime suvatimi do te kryhen ne Orenje ne gjatesi 158 ml duke eleminuar shume rrjedhje. Me keto punime do te permirsohet ujitja ne 100 ha duke perfituar fshati Orenje Verri dhe Floq.
- d) **Punime ne Kanal in e Zhushit Polis.** Me kete kanal me gjatesi 2.6 km mbulohet ujitja e pjeses me te madhe te fshatit Gostime me siperfaqe 110 ha dhe mbi 140 fermere. Ne pjesen e pare te ketij kanali , si pasoje e formacioneve te filtrushme dhe te paqendrushme, humbjet e ujit jane shume shqetesuese sa qe ne fshat nuk vjen as 30% e ujit qe futet ne fillim. Per kete arsye eshte planifikuar te kryhen punime germimi per ta futur kanal in ne bazament te qendrushem dhe punime betonimi per te eleminuar filtrimet e medha.
- e) **Kanali Gurr – Koce ne Zdrajsh Verri.** Fshati ka patur shqetesim se rrjedhjet dhe humbjet e ujit ne kete kanal kane qene te medha sa qe ujitja pengohet nderkohe qe ne burim ka uje te mjaftushem .Per kete arsye eshte parashikuar te kryhen punime germimi dhe betonimi dhe vendosja e 70 ml tubo korogato , ne veper marrje , per te eleminuar kete problem.
- f) **Kanali Domjon Gostime.** Ne kete kanal me te cili ujitjen 12 ha toke dhe perfitojne mbi 20 familje ka nje segment me gjatesi 200 ml me problem humbje uji per shkak te filtrimeve. Per kete arsye eshte planifikuar qe ky segmen te riparohet duke e veshur me beton.

- g) **Tombino ne fushen e Floqit.** Fermeret e fushes ne Floq kane shqetesim kalimin neper fushe sepse pengohen nga kanali kullues ne mes te saj. Per te zgjidhur kete shqetesim eshte projektuar te ndertohen 2 tombino me nga 5 ml gjatesi.
- h) **Shkarkuesi ne Ujembledhesin Dardhe.** Ne kete ujembledhes ekziston rreziku i kalimit te ujit mbi dige dhe kjo eshte me pasoje shkaterrimin e saj. Per kete arsye eshte parashikuar ndertimi i nje shkarkuesi sigurie.
- i) Nyja ndarese ne kanalin e Mesit ne Dorez. Ne kete kanal ka nje problem ndermjet fermereve te Dorzit dhe subjektit HEC qe punon me ujin e ketij kanali. Problemi qendron ne faktin se subjekti HEC ,ne kohe ujitje , merr ujin duke penguar ujitjen . Per kete arsye eshte projektuar ndertimi i nje nyje komandimi me qellim qe uji te komandohet nga fermeret dhe subjekti HEC te mos kete mundesi nderhyrje.

DREJTORIA BUJQESISE DHE USHQIMIT

DHJETOR 2018

